



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 10054 / Prot.

Tiranë, më 6 / 7 / 2021

UDHËZIM

Nr. 18, Datë 6.7 2021

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.16, DATË 8.5.2018,
“PËR ZHVILLIMIN E VETËVLERËSIMIT NË INSTITUCIONET OFRUESE TË
ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4 të nenit 29 të ligjit nr.15/2017, datë 16.2.2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” dhe të shkronjës ë; neni 8, nenit 14, dhe shtojcës 1; të ligjit nr. 10247, datë 04.03.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në Udhëzimin nr.16, datë 8.5.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zhvillimin e procesit të vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 2 e Kreut II, ndryshon si më poshtë:

“Vetëvlerësimi:

- a) përfshin të gjithë punonjësit e institucionit (drejtues, mësimdhënës dhe stafi mbështetës);
- b) kryhet çdo vit në 5 fushat e cilësisë mbështetur në “Udhëzuesin për vetëvlerësimin e IoAFP-ve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij Udhëzimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. Pika 6 e Kreut II “Organizimi dhe aspekte të metodologjisë” ndryshon si më poshtë:

“Etapat e vetëvlerësimit janë:

- a) Planifikimi i procesit të vetëvlerësimit të pesë fushave të cilësisë nga drejtoria e ofruesit të AFP-së në zbatim të kalendarit të miratuar nga AKAFPK.
- b) Përzgjedhja e instrumenteve të vlerësimit të brendshëm për secilën, fushë, nënfushë, tregues dhe kriter
- c) Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit dhe hartimi i raportit përfundimtar të vetëvlerësimit.

3. Në pikën 7, të Kreut II shtohet në fund “Pa vlerësim”.
4. Pika 2 e kreut III “Zhvillimi i vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional” ndryshon si më poshtë:
“Vetëvlerësimi kryhet nën drejtimin e ekipit përgjegjës, i cili përbëhet nga 3 anëtarë, nga të cilët kryetari është përgjegjësi i njësisë së zhvillimit në ofruesit publikë të AFP-së ose drejtuesi i njësisë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në ofruesit jopublikë të AFP-së. Ekipi përgjegjës përcakton një prej anëtarëve për përdorimin e platformës digjitale dhe hedhjen e të dhënave dhe gjetjeve në të.”
5. Shtojca 1 zëvendësohet me “Udhëzuesin për vetëvlerësimin e IoAFP-ve”
6. Shtojca 2 që i bashkëlidhet Udhëzimit nr.16, datë 08.05.2018 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

